

METODOLOGJIA E PERCAKTIMIT CMIMIT TE SHITJES SE
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Autoriteti

Kjo metodologji hartohet në zbatim të nenit 87 pika 4 të Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe në përputhje me Rregullat e Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kesaj metodologjie, eshte percaktimi i cmimit te shitjes se energjise elektrike te furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë Se Fundit bazuar ne parime te qarta te llogaritjes se kostove qe lidhen me kete sherbim, dhe detajimi i te dhenave te nevojshme per percaktimin e cmimeve te drejta dhe transparente.

Neni 3

Objekti

Objektivi i kësaj metodologjie eshte llogaritja e cmimit te shitjes se energjise elektrike te furnizuar nga furnizuesi i mundesise se fundit per klientet fundorë në përputhje me kriteret e përcaktuara ne nenin 86 te ligjit Nr.43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike”

Neni 4

Zbatimi

- a) Kjo metodologji do të zbatohet për te licensuarin e caktuar me sherbimin e Furnizuesit te Mundesise se Fundit në sektorin e energjisë elektrike, i caktuar ne perputhje me përcaktimet e pikes 2 te nenit 87 te ligjit Nr.43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike”.

METODOLOGJIA E PERCAKTIMIT CMIMIT TE SHITJES SE
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT

Neni 5

Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Metodologji do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- a) **Ligji për energjinë** do të thotë Ligji Nr 43/2015“Për Sektorin e Energjisë Elektrike.
- b) **Bordi i ERE”** do të thotë organi vendimarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr 43/2015 Për Sektorin e Energjisë Elektrike”
- c) **ERE** do të thotë autoriteti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror.”
- d) **Liçensë”**është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, dhe gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit të energjisë dhe ligjit të gazit natyror.
- e) **Furnizues i mundesise se Fundit** do të thotë një person i pajisur me licensë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike i caktuar nga ERE për të ushtruar funksionin e Furnizuesit të Mundesise se Fundit sipas ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Ai ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.
- f) **Procedurë** do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

METODOLOGJIA E PERCAKTIMIT CMIMIT TE SHITJES SE
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT

PJESA E DYTË
**PERCAKTIMI I CMIMIT TE SHITJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SE FUNDIT**

Neni 6

**Cmimi i energjise elektrike te funizuar nga Furnizuesi i Mundësisë se
Fundit**

Ne perckatimin e cmimit te furnizuesit te mundesise se fundit do te perfshihen kostot ne lidhje me blerjen e energjise elektrike, kostot e perdorimit te rrjetit te shperndarjes /transmetimit dhe kostot e sherbimit te funizimit te mundesise se fundit te cilat nuk duhet te jene me shume se 10% te totalit te kostove te blerjes se energjise elektrike per kete qellim.

Neni 7

Detyrime te tjera

Cmimi i llogaritur sipas percaktimeve te nenit 6 te kesaj Methodologjie nuk perfshin detyrimet ne lidhje me incentivimin e prodhimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme dhe detyrimet e tjera tatimore te cilat furnizuesi i mundesise se fundit eshte i detyruar ti identifikojë ne nje ze te vecante ne faturen e shitjes se enrgjise elektrike per klientin fundor te furnizuar prej tij.

Neni 8

Monitorimi i Cmimit te Furnizuesit te Mundesise se Fundit

(1) Furnizuesi i Mundesise se Fundit duhet te dorezoje dhe te argumentojë ne ERE per cdo muaj te gjitha kostot bazuar ne elementet e ketij cmimi sic percaktuar ne nenin 6 te kesaj metodologjie.

(2)ERE do te monitorojë dhe kontrolloj percaktimin e cmimit te furnizimit nga Furnizuesi i Mundesise se Fundit

METODOLOGJIA E PERCAKTIMIT CMIMIT TE SHITJES SE
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT

Neni 9

Publikimi

I licensuari i caktuar me shërbimin e Furnizimit të Mundësisë së Fundit ka detyrimin të publikojë cmimet për shërbimin e furnizimit të mundësisë së fundit të cilat duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme nga klientet.

**PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 10

Interpretimi

Ne rast se një çështje nuk është trajtuar në këto rregullore ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.

Neni 11

Dispozita tranzitore

Llogaritja e cmimit të energjisë së furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit para hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, do të korrigjohen në përputhje me kriteret e percaktimit të cmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit të percaktuar në këto metodologji.

Neni 12

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, si dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

METODOLOGJIA E PERCAKTIMIT CMIMIT TE SHITJES SE
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT